



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN  
DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS

Nr. 803 / Prot.

Tiranë, më 15.2. 2023

Lënda: Përcillen përfaqësuesit në Këshillin Konsultativ për Ndërmarrjet.

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit Nr.3, Tiranë

Në vijim të shkresës Suaj nr. 15893/3 prot., datë 10.11.2022 nëpërmjet së cilës kërkohet që Ministria e Arsimit dhe Sportit, në zbatim të ligjit nr. 43/2022 "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NVM)", të paraqesë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë emrat e 2 (dy) përfaqësuesve nga institucionet e arsimit të lartë në Këshillin Konsultativ për ndërmarrjet.

Ju bëjmë me dije se Komisioni Ad-Hoc i ngritur me urdhrin nr. 67, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, datë 06.02.2023 "Për ngritjen e Komisionit Ad-Hoc për kryerjen e procedurave mbi përzgjedhjen e përfaqësuesve të institucioneve të arsimit të lartë, në Këshillin Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme", shqyrtoi dosjet e 4 (katër) aplikantëve nga IAL-të publike dhe private, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin 43/2022 "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme" në vendimin nr. 541 të Këshillit të Ministrave, datë 29.7.2022 "Për Kriteret e përzgjedhjes si dhe për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Këshillit Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme", si dhe në urdhrin nr. 710 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, datë 01.12.2022, "Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së përfaqësuesve të institucioneve të arsimit të lartë (IAL) në Këshillin Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit", të publikuar në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Komisioni referuar kriterëve në aktet e sipërpërmendura e sidomos të eksperiencës në fushën e ekonomisë dhe të mbështetjes së zhvillimit të biznesit, ka përzgjedhur:

- 1) Nga institucionet publike të arsimit të lartë **Znj. Etleva Leskaj**,
- 2) Nga institucionet private të arsimit të lartë **Z. Xhimi Hysa**.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola

